



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3978 Prot

Lezhë, më 30 / 03 /2026

VENDIM

Nr. 33, Datë 26. 03. 2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.15, DATË 29.02.2024
“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS NË BASHKINË
LEZHË”**

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, Urdhrit Nr.281, datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe Vendimit Nr.393, datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi :

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Programin e Transparencës të Bashkisë Lezhë, konkretisht:

a) Shtohet fusha e 8 “Këshilli Bashkiak” e strukturuar në 8 nënfusha:

- Informacion rreth këshilltarëve;
- Informacion rreth komisioneve;
- Kuadri rregullator i këshillit të NJVV;
- Mbledhjet e Këshillit;
- Konsultimet Publike;
- Vendimet e Këshillit të NJVV;
- Kërkesa dhe përgjigje drejtuar Këshillit të NJVV;
- Veprimtaria e Këshillit, komunikimi me publikun dhe aspekte të tjera.

b) Fusha 1 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë” riformatohet në 6 nënfusha, pasi nënfusha 2 dhe 3 do të përfshihen në fushën 8.

c) Fusha 3 “Për kërkesat për informim” riformatohet në 4 nënfusha:

- Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Standartet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesën për informim dhe ankesën;
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
- Tarifa për dhënien e informacionit (nëse ka).

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULE





Nr. 3978/1 prot

Dt: 02.04.26

K.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI JURIDIK

Nr. 314/11 Prot.

Lezhë, më 01.04.2026

Lënda: Konfirmim vendimi.

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" *i ndryshuar*, ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" *i ndryshuar*, ligjin nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" *i ndryshuar*, konfirmoj bazushmërinë ligjore të vendimit nr.33, datë 26.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë " Për disa ndryshime në vendimin nr.15, datë 29.02.2024 "Për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Lezhë"

PREFEKTI

Taulant MALSHI

